


Nr. 71
Dt. 30.01.2020
PRISHTINË



Akademia e
Shkencave e
Shqipërisë
Sheshi "Fan Noli" nr. 7
Tiranë - Shqipëri



Akademia e Shkencave
dhe e Arteve e Kosovës
Rr. "Agim Ramadani"
nr. 305
Prishtinë - Kosovë

PROTOKOLL

PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR SHKENCOR DHE ARTISTIK NDËRMJET AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS (Për periudhën 1 shkurt 2020 - 31 dhjetor 2021)

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH) dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (më tej: ASHAK), me qëllim që të vazhdojnë të zhvillojnë një bashkëpunim të frytshëm kërkimor-shkencor midis tyre, pas bisedimeve dhe shkëmbimit të mendimeve për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndër-institucionale në përfundim të periudhës së protokollit 2018-2020, nënshkruajnë këtë Protokoll bashkëpunimi për periudhën 1 shkurt 2020 - 31 dhjetor 2021, duke mbajtur parasysh rëndësinë e shkëmbimit të informacionit shkencor, si dhe ndërmarrjen e nismave të përbashkëta shkencore nga të dyja palët, mbështetur në Marrëveshjen-kuadër ndërmjet dy akademive.

Veprimtaritë e përbashkëta të dy institucioneve do të zhvillohen sipas përshkrimit dhe kalendarit të mëposhtëm:

Nr.	Emërtimi i veprimtarisë	Vendi	Koha
1.	Konferencë kushtuar 200-vjetorit të Thimi Mitkos.	Tiranë	2020
2.	Konferenca e 50-të Ndërkombëtare e Studiuesve të Baladës.	Tiranë – Gjirokastrë	24-29, maj 2020
3.	Konferenca për poezinë shqipe në shek. XXI (vijim i konferencës për romanin shqiptar në shek. XXI).	Prishtinë	2020, qershor
4.	Konferencë shkencore: Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve sociale.	Prishtinë	2020, maj
5.	Konferencë shkencore: 30-vjetori i miratimit të Deklaratës Kushtetuese dhe i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.	Prishtinë	2020, shtator

6.	Përgatitje për <i>konferencën shkencore mbarëkombëtare në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit (1972-2022)</i> .	Tiranë	2020-2021
7.	Botim kontributesh shkencore për temën <i>Besimet dhe bashkëjetesa fetare te shqiptaret, me redaksi të përbashkët</i> (përfshihet përrurimi i botimit).	Tiranë-Prishtinë	2020, gjysma e dytë e vitit
8.	Këshilli Ndërkademik për Gjuhën Shqipe.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
9.	Mbështetje e përbashkët për projekte për mbrojtjen e trashëgimisë shpirtërore arbëreshe.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
10.	Bashkëpunim në kuadër të nismës shkencore për një Enciklopedi Shqiptare.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
11.	Nderimi i figurave kryesore akademike të palëve.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
12.	Konferencë albanologjike: gjuhësi, histori, arkeologji, etnologji, etnomuzikologji, etnokoreologji etj.	Tiranë	2021, mars
13.	Nxitja e bashkëpunimit për projekte të përbashkëta studimore në: infrastrukturë, pasuri minerare, ekologji, faunë, florë, gjuhë, enciklopedi, site arkeologjike.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
14.	Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhet satelitore: përfundimi i studimit aktual dhe mundësisht shtrirja në zona të tjera .	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
15.	Bashkëpunim për studimin e shpërndarjes në hapësirë dhe kohë të aerosoleve dhe temperaturave dhe të korelacionit mes tyre, nëpërmjet përpunimit të imazheve satelitore, modelimeve kompjuterike dhe krahasimit me matjet në terren.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
16.	Nxitje e bashkëpunimit për studimin e përqendrimeve të radiobërthamave me origjinë natyrore në mineralet në Shqipëri dhe Kosovë.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi

17.	Botim fjalorësh terminologjikë dhe frazeologjikë.	Prishtinë-Tiranë	2020 e në vazhdimësi
18.	Nxitja e bashkëpunimit për ngritjen e qendrave kërkimore në fusha të reja: robotikë, inteligjencë artificiale, bioteknologji, nanoteknologji, energjetikë .	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
19.	Vazhdimi i punës për një platformë të përbashkët për një qasje të hapur në botimet dhe periodikët shkencorë.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
20.	Koncerte dhe ekspozita të përbashkëta me vepra të kompozitorëve dhe të artistëve të Shqipërisë dhe të Kosovës.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
21.	Shkëmbime dhe përrurime nga bibliotekat: - Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore dhe artistike të palëve; - Botime të ndërsjella dhe promovime të rezultateve kërkimore shkencore dhe artistike; - Përrurime të botimeve shkencore dhe artistike të të dy akademive, në Tiranë dhe në Prishtinë; - Ekspozita dhe përrurime të ndërsjella të librit akademik.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi
22.	Bashkëpunim profesional ndërmjet bibliotekave: - Katalogimi online i fondeve albanologjike; - Bibliografite online të kërkuesve shkencorë; - Shkëmbim eksperience në katalogim dhe përrurime të bibliografive online të kërkuesve shkencorë shqiptarë; - Kualifikim profesional i stafit bibliotekar mbi katalogimin e njësive bibliografike.	Tiranë-Prishtinë	2020 e në vazhdimësi

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy akademive do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Dy akademitë bashkëpunojnë për veprimtari të tjera jashtë këtij Protokolli duke u marrë vesh në proces e sipër.

Mënyra e financimit të projekteve të përbashkëta koordinohet me marrëveshje të veçanta për secilën pikë të programit të bashkëpunimit.

Ky Protokoll mund të ndryshohet me miratimin e të dy akademive, në varësi të prioriteteve të kohës dhe të sigurimit të mjeteve financiare.

Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare duke filluar nga data 1 shkurt 2020.

Nënshkruar në Tiranë, më 30 janar 2020, në dy kopje, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.

**PËR AKADEMINË E
SHKENCAVE
TË SHQIPËRISË**

Akademik Skënder Gjinushi, kryetar

The block contains a blue ink signature of Akademik Skënder Gjinushi. Below the signature is a circular official stamp. The outer ring of the stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top and "AKADEMIA E SHKENCAVE" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of the Republic of Kosovo, which features a double-headed eagle.

**PËR AKADEMINË E
SHKENCAVE DHE
TË ARTEVE
TË KOSOVËS**

Akademik Mehmet Kraja, kryetar

The block contains a blue ink signature of Akademik Mehmet Kraja. Below the signature is a circular official stamp. The outer ring of the stamp contains the text "AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS". In the center of the stamp is a stylized logo consisting of a triangle and a circle. Below the logo, the text "PRISHTINE 1975" is visible.